



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Logjistikës dhe Digjitalizimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

“MIRATIMIN E SASISË SË VULAVE REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, QË DO TË
PRODHOHEN PËR ZGJEDHJET E PJESHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24
SHTATOR 2023”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator ose Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”, ka caktuar rregullat për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë në Komisionet e Qendrave të Votimit.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 5, datë 19.02.2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 28.12.2020”, ka përcaktuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, prodhon vula rezervë me tekst unik për zëvendësimin e vulës së KQV-së apo vulës së Kryetarit të KQV-së, të nxjerrë nga përdorimi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përcakton:

- Numrin e vulave rezervë që do të prodhohen;
- Formatin, tekstin dhe numrin serial të çdo vule rezervë;

Në bazë të përcaktimeve të vendimeve si më lart cituar, vlerësohet që në zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, sasia e vulave rezerve që do të prodhohen të jetë 5 copë.



II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Formati dhe specifikimet e vulës rezervë të KQV janë miratuar me vendimin nr. 723, datë 19.08.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, vulës së Komisionit të Qendrës së votimit, vulës së kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së votimit”, për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e sasisë të vulave rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit, që do të prodhohen për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”.

Daniela Alimemeti – **Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit**

Ylli MERKAJ – **Sekretar i Përgjithshëm**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data:

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**“MIRATIMIN E SASISË SË VULAVE REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, QË DO TË
PRODHOHEN PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR
2023”**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 103, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, të prodhohen 5 (pesë) vula rezervë të KQV-së.
2. Teksti i vulës rezervë është unik për çdo vulë dhe përbëhet nga shkronja “R”.
3. Formatit dhe specifikimet e vulës rezervë të KQV-së janë sipas lidhjes 4, miratuar me vendimin nr. 723, datë 19.8.2023.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 2023 Nr:
Ora:



“Për miratimin e sasisë së vulave rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit, që do të prodhohen për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”